



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës datë 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.04.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeria-pronat komunale që gjenden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të përshkruar si në vijim:

Nr.	Pronar	Zona Kadastrale	Parcela Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Komuna Lipjan	Babush i Muhaxherëve	P-71409059-00559-4	16132
2.	Komuna Lipjan	Babush i Muhaxherëve	P-71409059-00555-2	3868

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi, bëhet në mënyrë që subjekteve të interesuara të i u mundësohet të ofrojnë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit, sipas standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Pronat e paluajtshme komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë siç përcaktohet në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr.15.463-32604 i datës 30.07.2020.

15 Nr. 462/01-2023

Lipjan, më 24.04. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

